



Water and Waste Regulatory Office  
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina  
Regulatorni Ured za Vodu i Otpad

**UNMIK**



ZRRUM – R 01 / SWD

ZYRA RREGULLATORE E UJIT DHE MBETURINAVE (“ZRRUM”)

---

**RREGULL  
PËR LICENCIMIN  
E OPERATORËVE TË DEPONIVE E MBETURINAVE  
NË KOSOVË**

26 - Janar - 2005

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>TABELA E PËRMBAJTJES.....</b>	<b>2</b>
<b>PJESA 1: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>6</b>
<b>Kapitulli 1: Autoriteti, Fushëveprimi, Qëllimi dhe Përkufizimet .....</b>	<b>6</b>
Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull.....	6
Neni 2: Fushëveprimi.....	6
Neni 3: Qëllimi.....	6
Neni 4: Përkufizimet.....	6
Neni 5: Rregullat e Interpretimit.....	8
<b>Kapitulli 2: Dispozitat e Përgjithshme të Operimit të Licencës së Shërbimit.....</b>	<b>9</b>
Neni 6: Aplikueshmëria .....	9
Neni 7: Afati i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....	9
Neni 8: Numri i Licencave të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....	9
Neni 9: Shpenzimet për Marrjen e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave....	9
Neni 10: Kufizimet.....	9
<b>PJESA 2: APLIKACIONI PËR LICENCËN E SHËRBIMIT TË DEPONIMIT TË MBETURINAVE.....</b>	<b>10</b>
<b>Kapitulli 1: Procedurat e Përgjithshme për Aplikacionin e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....</b>	<b>10</b>
Neni 11: Aplikacioni për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	10
Neni 12: Format e Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.	10
Neni 13: Taksa për Aplikacionin për Licencën e Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave	10
Neni 14: Aprovimi i Bordit Mbikqyrës.....	10
Neni 15: Aprovimi i Deklaratës Financiare .....	10
Neni 16: Autorizimi i Operimit.....	10
Neni 17: Dëftesa nga Rregullatori.....	11
<b>Kapitulli 2: Identifikimi I Kërkesit .....</b>	<b>11</b>
Neni 18: Identifikimi i Aplikuesit.....	11
Neni 19: Komunitet dhe Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të Shërbyer .....	11
<b>Kapitulli 3: Pronësia mbi Pasuritë dhe Shfrytëzimi i Tokës së Regjistruar.....</b>	<b>11</b>
Neni 20: Pronësia mbi Pronën dhe e Drejta për Shfrytëzim .....	11
Neni 21: Shfrytëzimi i Regjistruar i Tokës .....	12
Neni 22: Të Drejtat e Mineraleve.....	12
<b>Kapitulli 4: Deponia e Mbeturinave.....</b>	<b>12</b>
Neni 23: Pronari dhe Emri i Deponisë së Mbeturinave .....	12
Neni 24: Licencat dhe Lejet Tjera.....	12
Neni 25: Detajet e Zhvillimit të Deponisë së Mbeturinave.....	12
Neni 26: Lokacioni dhe Përshkrimi i Deponisë së Mbeturinave .....	13

Neni 27: Pajisja e Vendit të Deponisë së Mbeturinave.....	14
Neni 28: Tarifat e Shërbimit .....	14
Neni 29: Struktura Operative .....	14
<b>Kapitulli 5: Konsideratat për Mjedisin.....</b>	<b>15</b>
Neni 30: Ndikimet në Mjedis.....	15
Neni 31: Plani i Mbylljes së Deponisë së Mbeturinave .....	15
<b>Kapitulli 6: Sigurimi dhe Garancionet Financiare .....</b>	<b>16</b>
Neni 32: Sigurimi i Detyrimeve të Përgjithshme.....	16
Neni 33: Garancioni i Zbatimit .....	16
<b>Kapitulli 7: Dokumentet Shoqëruese të Nevojshme .....</b>	<b>17</b>
Neni 34: Biografia e secilit Menaxher të Lartë.....	17
Neni 35: Dokumentet e kërkuara të biznesit së bashku me Aplikacionin.....	17
Neni 36: Tatimi mbi Pronën, Tatimet Tjera të Aplikueshme, Faturat e Ndërmarrjeve si dhe Detyrimet që kanë të bëjnë me to.....	18
<b>PJESA 3: SHQYRTIMI I APLIKACIONIT DHE LËSHIMI I LICENCËS PËR SHËRBIME PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE .....</b>	<b>18</b>
<b>Kapitulli 1: Shqyrtimi i Aplikacionit .....</b>	<b>18</b>
Neni 37: Shqyrtimi i Përgjithshëm i Kërkesës dhe Dokumenteve Shoqëruese .....	18
Neni 38: Pamundësia për të Ofruar Informatat e Kërkuara .....	19
Neni 39: Shqyrtimi i detajizuar i Kërkesës .....	19
Neni 40: Kërkuarja e Informatave Plotësuese.....	19
<b>Kapitulli 2: Lëshimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....</b>	<b>19</b>
Neni 41: Lëshimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	19
Neni 42: Mos-Diskriminimi.....	20
<b>PJESA 4: LICENCA E SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE .....</b>	<b>20</b>
<b>Kapitulli 1: Përmbajtja e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....</b>	<b>20</b>
Neni 43: Përmbajtja e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	20
<b>Kapitulli 2: Obligimet e Operatorit të Deponisë së Mbeturinave .....</b>	<b>21</b>
Neni 44: Obligimet e të gjithë Operatorëve të Deponive të Mbeturinave .....	21
<b>PJESA 5: REFUZIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE.....</b>	<b>22</b>
Neni 45: Refuzimi për të lëshuar ose Ripërtërirë Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	22
<b>PJESA 6: RIPËRTËRIRJA OSE TRANSFERI I LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN TË MBETURINAVE .....</b>	<b>23</b>

<b>Kapitulli 1: Ripërtërirja ose Transferi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....</b>	<b>23</b>
Neni 46: Ripërtërirja e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	23
Neni 47: Transferi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	23
<b>PJESA 7: NDRYSHIMET, SHUARJA DHE REVOKIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE.....</b>	<b>23</b>
Neni 48: Ndryshimet, Plotësimet, ose Zëvendësimet në Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....	23
Neni 49: Ndryshimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	24
Neni 50: Shqyrtimi i Kualifikimeve të Drejtorit Menaxhues dhe Menaxherit Operativ të Deponisë së Mbeturinave .....	24
Neni 51: Informimi i Rregullatorit për Ndryshimet e Rëndësishme.....	24
<b>Kapitulli 2: Përfundimi, Revokimi ose Dorëzimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....</b>	<b>25</b>
Neni 52: Përfundimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	25
Neni 53: Revokimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	25
Neni 54: Dorëzimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	25
<b>PJESA 8: MARRËVESHJA PËR KUSHTET E LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE .....</b>	<b>26</b>
Neni 55: Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	26
Neni 56: Negociatat për Marrëveshjen e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	26
Neni 57: Hyrja në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	27
Neni 58: Karakteri Ligjor dhe Zbatimi i Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave .....	27
Neni 59: Pajtueshmëria me Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....	28
<b>PJESA 9: ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT.....</b>	<b>28</b>
<b>Kapitulli 1: Monitorimi dhe Zbatimi i Kushteve të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....</b>	<b>28</b>
Neni 60: Monitorimi i Respektimit.....	28
<b>Kapitulli 2: Raportet dhe Shënimet për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.....</b>	<b>28</b>
Neni 61: Shënimet dhe Raportet .....	28
<b>Kapitulli 3: Kundërvajtjet dhe Dënimet.....</b>	<b>30</b>
Neni 62: Kundërvajtjet dhe Dënimet .....	30
<b>Kapitulli 4: Ankesat.....</b>	<b>30</b>
Neni 63: Ankesat.....	30

<b>PJESA 10: TË NDRYSHME</b> .....	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>
Neni 64: Gjuhët .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Neni 65: Hyrja në Fuqi .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

<b>SHTOJCAT</b> .....	<b>32</b>
SHTOJCA 1(a) .....	33
FORMULARI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE NË KOSOVË .....	33
SHTOJCA 1 (b) .....	38
APROVIMI NGA BORDI MBIKQYRËS .....	38
SHTOJCA 1 (c) .....	39
APROVIMI I DEKLARATAVE FINANCIARE .....	39
SHTOJCA 1 (d) .....	40
AUTORIZIMI PËR TË OPERUAR .....	40
SHTOJCA 1(e) .....	41
LISTA KONTROLLUESE E KOMPLETUESHMËRISË ADMINISTRATIVE .....	41
SHTOJCA 1(f) .....	44
CERTIFIKATA E LICENCËS .....	44
SHTOJCA 1 (g) .....	45
FORMATI I BIOGRAFISË .....	45

## PJESA 1: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Kapitulli 1: Autoriteti, Fushëveprimi, Qëllimi dhe Përkufizimet

#### Neni 1: Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori nxjerr këtë Rregull nën autoritetin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave i datës 26. Nëntor 2004.

#### Neni 2: Fushëveprimi

Të gjitha Ndërmarrjet Publike që aktualisht operojnë Deponitë e Mbeturinave duhet të parashtrijnë Aplikacionin për Licencë të Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave sipas dispozitave të kësaj Rregulle.

#### Neni 3: Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është të përcaktohet procedura sipas së cilës duhet të aplikohet për dhënien, mirëmbajtjen, përtërirjen dhe anulimin e Licencës së Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave për operimin dhe menaxhimin e Deponisë së Mbeturinave.

#### Neni 4: Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregull duhet të përmbajnë kuptimet si në vijim:

“**Aplikacioni**” nënkupton Aplikacionin për Licencim të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;

“**Aplikimi për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**” nënkupton Aplikimin në një formë të përshkruar nga Rregullatori, me dokumentacionin e dorëzuar nga një Aplikues për Licencë të Shërbimit me qëllim të marrjes së Licensës për Shërbime të Deponimit të Mbeturinave;

“**Aplikuesi**” nënkupton çdo Ndërmarrje Publike që aplikon te Rregullatori për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave apo për vazhdim të Licensës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;

“**Banor**” nënkupton personin që jeton apo banon apo është i vendosur në ndonjërin nga Rajonet e Shërbimit;

“**Deponia e Mbeturinave**” nënkupton një vend apo lokacion të licencuar nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor për Mbeturinat e Ngurta Komunale dhe çfarëdo materie tjetër tepërisë pasi që Mbeturinat e Ngurta Komunale janë procesuar dhe kthimi i produkteve apo energjisë së shndërrimit është arritur;

“**Ditë e Punës**” nënkupton çdo ditë, përveç të shtunës, dielës, ditë pushimi të njohur me ligj apo pushim publik në Kosovë;

“**Garantimi i Përmbushjes**” nënkupton instrumentin financiar që garanton përmbushjen e plotëfuqishme të Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave;

“**Komisioni Shqyrtues**” nënkupton komisionin që shqyrton vendimet e Rregulatorit sipas Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 të datës 26 Nëntor 2004;

**“Kushtet e Licensës për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave”** nënkupton kushtet specifike nën të cilat Rregullatori i lëshon Licencën për Shërbimet për Deponimin e Mbeturinave Operatorit të Deponisë së Mbeturinave;

**“Licenca e Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave”** nënkupton instrumentin ligjor të lëshuar nga Rregullatori si pauses i kësaj Rregulle, që themelon kushtet dhe konditat sipas të cilave duhet të ofrohen Shërbimet për Deponimin e Mbeturinave në Kosovë;

**“Marrëveshja e Kushteve të Licencës për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave”** nënkupton marrëveshjen në mes të Rregullatorit dhe Operuesit të Shërbimit në Deponinë e Mbeturinave për përmirësimin, ndryshimin dhe/ose plotësimin e çfarëdo Kushtesh të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulle;

**“Mbeturinat e Ngurta Komunale”** nënkuptojnë mbeturinat e ngurta nga amvisiritë, dyqanet, burimet institucionale apo industriale dhe mbeturinat e procesuara që nuk janë të Rrezikshme, Mjekësore, apo Mbeturinat Toksike;

**“Mbeturinat e Rrezikshme”** nënkupton nus-produktet të shoqërisë që paraqesin rrezik substancial ose potencial për shëndetin njerëzor kur ato menaxhohen në mënyrë joadekuate. Substancat e klasifikuara si mbeturina të Rrezikshme posedojnë së paku njërin nga katër karakteristikat në vijim: janë të ndezëshme, janë korrozive, janë reaktive apo janë helmuese, ose janë klasifikuar si Mbeturina të Rrezikshme sipas standardeve menaxhuese të Bashkimit Evropian për mbrojtje ambientale dhe/ose mbeturina të ngurta;

**“Mbeturinat Mjekësore”** duhet të thotë çdo hedhurinë që paraqet rrezik specifik për shëndetin publik dhe/apo ambientin që ka origjinën nga një vend apo aktivitet ku ofrohet përkujdesi mjekësor dhe përfshinë produkte mbeturinash infektive, anatomike, të mprehta, kimike dhe farmaceutike. Çdo mbeturinë që ka origjinën nga një vend apo aktivitet i tillë që ofron përkujdes mjekësor e që nuk paraqet rrezik specifik të përmendur në këtë definicion duhet të njihet si "Mbeturinat e Ngurta Komunale" që kanë origjinën nga një institucion komercial;

**“Mbeturinat Toksike”** nënkupton një produkt hedhurinë që mund të shkaktoj lëndim nëse thithet, përbihet apo absorbohet përmes lëkurës;

**“Menaxheri i Operimeve të Deponisë së Mbeturinave”** nënkupton punëtorin e lartë të Operuesit të Deponisë së Mbeturinave i cili duhet të ketë autoritet të drejtëpërdrejtë dhe përgjegjësi për operimin dhe menaxhimin e Deponisë së Mbeturinave;

**“Ndërmarrje Pulike”** nënkupton ndërmarrjen që është krijuar si pronë publike në Kosovë, ashtu siç është definuar në Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 të 13 Korrikut 2002 Mbi themelimin e Agjensionit Kosovarë të Mirëbesimit;

**“Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave”** nënkupton secilin person që ofron apo që synon të ofroj Shërbim të Mbledhjes së Mbeturinave;

**“Operuesi i Deponisë së Mbeturinave”** nënkupton Personin e licencuar nga Rregullatori që të operojë dhe menaxhojë Deponinë e Mbeturinave në Kosovë;

**“Person”** nënkupton cilindo individ, subjekt ligjor apo publik përfshirë korporatë, bashkëpjesëmarrje, trust, organizatë të inkorporuar, qeveri apo çfardo agjensioni ose nënsektori të saj;

**“Regjion”** nënkupton një rajon të definuar në Planin e Konsolidimit që përfshinë në tërësi apo pjesërisht më shumë se një Komunë;

**“Rregullatori”** nënkupton autoritetin përgjegjës për Rregullimin ekonomik të sektorëve të Ujit dhe Mbeturinave sipas ligjeve të aplikueshme të cilave poashtu u referohen si Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina ("ZRRUM") apo organizatë që do ta trashëgojë atë;

**“Shërbimet për Deponimin e Mbeturinave”** nënkupton deponimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale në Deponinë e Mbeturinave;

**“Standardet e Shërbimit”** nënkuptojnë, sa i përket Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave, standardet që aplikohen në atë shërbim në përputhje me Udhëzimin Administrativ dhe minimumi i niveleve të shërbimeve të operimit dhe menaxhimit që vendosen nga Rregullatori në Kushtet për Licencë të Shërbimit të Deponimit së Mbeturinave;

**“Taksa e Aplikimit për Shërbimet e Deponisë së Mbeturinave”** nënkupton pagesën zyrtare të pakthyeshme që duhet ti paguhet Rregullatorit nga Aplikuesi me rastin e dorëzimit të aplikacionit për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave sipas kësaj Rregulle;

**“Taksa e Licencës së Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave”** nënkupton taksën zyrtare të pakthyeshme që duhet ti paguhet Rregullatorit nga të gjithë Operuesit e Deponimit të Mbeturinave;

**“Taksa Vjetore e Licencës”** nënkupton taksën që duhet ti paguhet në bazë vjetore Rregullatorit nga të gjithë Operuesit e Deponive të Mbeturinave me qëllim që të mundësohet vazhdimi i gëzimit të të drejtave të dhëna nga Rregullatori sa i përket dispozitave për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave;

**“Tarifat e Shërbimit”** nënkuptojnë çfarëdo vlere, çmimi apo takse të Operuesit të Deponisë në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Deponimit të Mbeturinave;

**“Udhëzim për Operime”** nënkupton dokumentin e përgaditur nga Aplikuesi dhe të bashkangjitur Aplikacionit ku përshkruhen standardet teknike të operimit të Deponisë së Mbeturinave të mbuluar nga Licensa për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave të kërkuara në nën-paragrafin 30.7, që përdoret si baza për themelimin dhe zbatimin nga Rregullatori i Standardeve të Shërbimit;

**“Zona e Shërbimit”** nënkupton, sa i përket Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave, Rajonin apo Komunën brenda të cilit Operuesi Relevant për Deponimin e Mbeturinave është i autorizuar që të ofrojë Shërbimet e tij për Deponimin e Mbeturinave;

#### Neni 5: Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë definuar veçanërisht dhe të cilat mund të jenë të paqarta, do të përmbajnë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të përmendura në Rregullore që autorizon këtë Rregull ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull duhet të interpretohen sipas kuptimit të cilësdo Rregulle të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me mandatin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët e cilësdo gjini që përdoren në këtë Rregull duhet të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse qëllimisht nuk caktohet ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të kësaj Rregulle.



## **Kapitulli 2: Dispozitat e Përgjithshme të Operimit të Licencës së Shërbimit**

### Neni 6: Aplikueshmëria

Të gjitha Ndërmarrjet Publike që aktualisht i operojnë Deponitë e Mbeturinave duhet që të parashtrijnë Aplikacion për Licencën e Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave sipas dispozitave të kësaj Rregulle.

### Neni 7: Afati i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 7.1 Secila Licencë për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave duhet të lëshohet për një kohëzgjatje të caktuar prej jo më pak se pesë (5) vite dhe jo më shumë se dhjetë (10) vite kalendarike.
- 7.2 Pavarësisht nga kufizimi i vendosur në nën-Nenin 7.1 të lartëshënuar, kohëzgjatja e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave asnjëherë nuk duhet të tejkalojë jetëzgjatjen e projektuar të Deponisë së Mbeturinave.

### Neni 8: Numri i Licencave të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Numri i Licencave të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të lëshuara nga Rregullatori duhet të ketë kufizimet si në vijim:

- (a) Jo më shumë se një (1) Licencë të Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave duhet të lëshohet për operim dhe/ose menaxhim të cilësdo Deponi të Mbeturinave;
- (b) Ndërmarrja Publike e cila dëshiron të operojë dhe menaxhojë më shumë se me një (1) Deponi të Mbeturinave, në bazë të Aplikacionive të kësaj Rregulle, duhet të parashtrij Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave ndaras për secilën Deponi të Mbeturinave;
- (c) Të gjitha Ndërmarrjet Publike që aktualisht i operojnë Deponitë e Mbeturinave duhet të aplikojnë për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave sipas dispozitave të kësaj Rregulle.

### Neni 9: Shpenzimet për Marrjen e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 9.1 Të gjitha shpenzimet e pësura nga Aplikuesi për Licencën e Shërbimit, lidhur me aplikacionin për Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, duke përfshirë edhe Taksën e Aplikacionit për Licencën të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të paraqitur në Neni 13, duhen të jenë në përgjegjësi të vetme të Aplikuesit për Taksën e Licencës së Shërbimit.
- 9.2 Në Tarifën e Shërbimit Operatori i Deponimit të Mbeturinave duhet të përfshijë shumën e shpenzimeve që referohen në nën-Nenin 9.1 të lartëshënuar.

### Neni 10: Kufizimet

- 10.1 Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave e lëshuar nga Rregullatori do të jetë në mënyrë specifike vetëm për operimin dhe menaxhimin e Deponisë së Mbeturinave për Mbeturina jo të rrezikshme të Ngurta Komunale sipas kushteve të Licencës në fjalë.
- 10.2 Rreptësisht i ndalohet cilitdo Person të operojë dhe menaxhojë cilëndo Deponi të Mbeturinave nëse nga Rregullatori nuk i është lëshuar Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.

## **PJESA 2: APLIKACIONI PËR LICENCËN E SHËRBIMIT TË DEPONIMIT TË MBETURINAVE**

### **Kapitulli 1: Procedurat e Përgjithshme për Aplikacionin e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**

#### Neni 11: Aplikacioni për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Të gjithë Operatorët e pranueshëm të palicencuar ekzistues të cilët e operojnë Deponinë e Mbeturinave duhet të parashtrojnë Aplikacionin e kompletuar për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave sipas dispozitave të kësaj Rregulle brenda tetë (8) muajve kalendarik prej datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.

#### Neni 12: Format e Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Të gjitha Aplikacionit duhet të dorëzohen në tri kopje tek Rregullatori (një origjinal dhe dy kopje) në dhe sipas udhëzimeve të paraqitura në Formën e Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave që janë të paraqitura në shtojcën e kësaj Rregulle.

#### Neni 13: Taksa për Aplikacionin për Licencën e Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave

- 13.1 Aplikuesi i Licencës së Shërbimit duhet të paguajë në tërësi Taksën e pakompenzueshme të Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, e cila duhet të ridërgohet në të holla të gatshme tek Rregullatori në të njëjtën kohë kur të dorëzohet Aplikacioni.
- 13.2 Rregullatori duhet të dërgojë te Aplikuesi faturën në shumën e barasvlershme me taksën e pranuar në bazë të dispozitave të nën-Nenit 13.1 të lartëshënuar.

#### Neni 14: Aprovimi i Bordit Mbikqyrës

- 14.1 Para dorëzimit të Aplikacionit në fjalë, Aplikacioni duhet të aprovohet nga Bordi Mbikqyrës.
- 14.2 Aprovimi nga Bordi Mbikqyrës siç është përcaktuar në nën-Nenin 14.1 të lartëshënuar, duhet të ipet në formë të letrës sipas përmbajtjes dhe formatit të përcaktuar në shtojcën e kësaj Rregulle dhe duhet të i bashkangjitet Aplikacionit.

#### Neni 15: Aprovimi i Deklaratës Financiare

- 15.1 Aplikuesi së bashku me Aplikacionin duhet të parashtroj edhe kompletin e deklaratave financiare, të aprovuara nga zyrtari i lartë financiar i AKM-s, ose nga cilido person i autorizuar për këtë qëllim nga Bordi Mbikqyrës i Agjensionit Kosovar të Mirëbesimit ose pasardhësit të tij.
- 15.2 Aprovimi i deklaratave financiare të kërkuara në bazë të nën-Nenit 15.1 të lartëshënuar, duhet të dëshmojnë në formë të letrës të nënshkruar dhe të vulosur nga zyrtari i lartë financiar ose Personi i autorizuar dhe duhet të jenë sipas përmbajtjes dhe formatit të dhënë në shtojcën e kësaj Rregulle dhe duhet të i bashkangjiten Aplikacionit.

#### Neni 16: Autorizimi i Operimit

Të gjithë Aplikuesit së bashku me Aplikacionin e tyre duhet të parashtrojnë letrën nga Agjensionin Kosovar të Mirëbesimit të nënshkruar nga Menaxheri i Divizionit të Ujit, Mbeturinave dhe Ujitjes e cila konfirmon se Aplikuesi është i autorizuar për të operuar dhe

menaxhues Deponinë të Mbeturinave nën kujdestarin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe e cila duhet të jetë sipas përmbajtjes dhe formatit të dhënë në shtojcën e kësaj Rregulle.

#### Neni 17: Dëftesa nga Rregullatori

- 17.1 Rregullatori, duhet të i lëshoi Aplikuesit të Licensës një njoftim me shkrim për pranimin e Aplikacionit së bashku me dokumentet përcjellëse dhe me konfirmim të datës dhe kohës së pranimit të tyre, jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune nga pranimi i Aplikacionit.
- 17.2 Njoftimi me Shkrim i lëshuar në bazë të nën-Nenit 17.1 nuk duhet të detyrojë Rregullatorin për sa i përket miratimit, kompletimit administrativ si dhe/ose aprovimit të Aplikacionit.

### **Kapitulli 2: Identifikimi I Kërkuesit**

#### Neni 18: Identifikimi i Aplikuesit

Aplikuesi duhet të ofrojë, në pjesën e duhur të Formës së Aplikacionit për Licencë të Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave siç është dhënë në shtojcën e kësaj Rregulle, informatat e përgjithshme identifikuese si dhe informatat tjera të cilat mund të paraqiten dhe kërkohen në formularin në fjalë si në vijim:

- (a) Emri dhe adresa e Aplikuesit: Kjo duhet të përmbajë emrin e plotë dhe adresën e selisë së biznesit, numrin e telefonit kryesor, numrin e telefonit mobil kryesor, numrin e faksit si dhe adresën elektronike (e-mail);
- (b) Kontakt personi i Aplikuesit: Emri i plotë dhe kontakt detajet e personit i cili është i autorizuar të përgadisë dhe të hartojë Aplikacionin dhe të cilin Rregullatori mëpastaj mund ta kontaktojë për cilatdo pyetje lidhur me Aplikacionin;
- (c) Menaxherët e lartë të Aplikuesit duhet të jenë emrat dhe adresat e Kryesuesit të Bordit Mbikqyrës, Drejtorit Menaxhues ose Menaxherit Kryesor, Zyrtarit të Lartë Financiar, Menaxherit të Lartë Operativ; dhe
- (d) Aplikuesi duhet të parashtojë përshkrimin e përvojës së tij të operimit dhe menaxhimit të Deponisë së Mbeturinave.

#### Neni 19: Komunitat dhe Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të Shërbyer

Aplikuesi duhet të ofrojë informacionin që ka të bëjë me Komunitat dhe Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave si në vijim:

- (a) Emrat e Komunitave të cilave duhet të u marrin shfrytëzuesit shërbimet nga Deponia e Mbeturinave;
- (b) Emrat e Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të cilët duhet të jenë të autorizuar të shfrytëzojnë Deponinë së Mbeturinave;
- (c) Një vlerësim i numrit të plotë të Banorëve në Zonën e Shërbimit;

### **Kapitulli 3: Pronësia mbi Pasuritë dhe Shfrytëzimi i Tokës së Regjistruar**

#### Neni 20: Pronësia mbi Pronën dhe e Drejta për Shfrytëzim

Aplikuesi duhet të ofrojë përshkrimin ligjor të shfrytëzimit të regjistruar të pronës duke përfshirë referencën në koordinatat gjeografike, numrin e parcelës, ashtu siç është e shënuar

në fletën kadastrale dhe në fletën poseduese që mbahet në Zyren e duhur Kadastrale Komunale.

#### Neni 21: Shfrytëzimi i Regjistruar i Tokës

Aplikuesi duhet të ofrojë përshkrimin dhe shfrytëzimin e pronës, e cila duhet të jetë e njëjtë me atë siç është e shënuar në fletën kadastrale dhe në fletën poseduese që mbahet në Zyren e duhur Kadastrale Komunale.

#### Neni 22: Të Drejtat e Mineraleve

Aplikuesi duhet të dëshmojë nëse operimi i Deponisë së Mbeturinave bie apo nuk bie ndesh lidhur me cilëndo të drejtë të hulumtimit të mineraleve në pronë. Letra nga Drejtorati i Minerave dhe Mineraleve që konfirmon dëshminë e Aplikuesit, duhet të bashkëngjitet Aplikacionit.

### **Kapitulli 4: Deponia e Mbeturinave**

#### Neni 23: Pronari dhe Emri i Deponisë së Mbeturinave

Aplikuesi duhet të ofrojë informatën që ka të bëjë me Deponinë e Mbeturinave si në vijim:

- (a) Emrin me të cilin njihet ose është e regjistruar Deponia e Mbeturinave. Kjo duhet të regjistrohet nga Rregullatori në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave
- (b) Emri legal i entitetit i cili është pronar legjitim i Deponisë së Mbeturinave. Kjo duhet të regjistrohet nga Rregullatori në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
- (c) Adresa e Deponisë së Mbeturinave; dhe
- (d) Numri i telefonit kryesor dhe numri i faksit i Deponisë së Mbeturinave

#### Neni 24: Licencat dhe Lejet Tjera

- 24.1 Aplikuesi duhet të ofrojë kopjen e lejes së ndërtimit, të lëshuar nga Komuna brenda së cilës është e përcaktuar vendndodhja e Deponisë së Mbeturinave që autorizon ndërtimin e Deponisë së Mbeturinave.
- 24.2 Aplikuesi duhet të ofrojë dëshminë e dokumentuar se janë nxjerrë licencat dhe lejet relevante që kërkohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe që janë specifike për Deponinë e Mbeturinave për të cilën është parashtruar Aplikacionin për Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.
- 24.3 Aplikuesi duhet të ofrojë dëshminë e dokumentuar se i ka nxjerrë licencat dhe lejet relevante të kërkuesit nga Instituti i Shëndetit Publik dhe që janë specifike për Deponinë e Mbeturinave për të cilën është parashtruar Aplikacioni për Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.

#### Neni 25: Detajet e Zhvillimit të Deponisë së Mbeturinave

- 26.1 Aplikuesi bashkë me Aplikacionin duhet të ofrojë detajet e zhvillimit të deponisë si në vijim:
  - (a) Vizatimet në përpjesë dhe dimensione të përshtatshme që qartë identifikojnë kufijtë e pronës duke përfshirë edhe zonën posaçërisht të rezervuar për deponimin e mbeturinave të ngurta; dhe

- (b) Vizatimet në përpjesë dhe dimensione të përshtatshme që qartë tregojnë transhetë e drenazhit të kanaleve sipërfaqësore; dhe
- (c) Përshkrimin dhe Vizatimet në përpjestë dhe dimensione të duhura të ndërtesave, strukturave, rrethojave për sigurim, rrugëve që çojnë në pronë, rrugëve të brendshme në pronë, dhe fushave të parkimit të automjeteve të propozuara ose ekzistuese;
- (d) Jetëzgjatja e Pritur sipas Projektit dhe kapaciteti i deponimit në kuptim të:
  - (i) llogaritjes së kapacitetit total volumetrik dhe të peshës së Mbeturinave të Ngurta Komunale të cilat duhet të hudhen në deponi dhe të shprehura respektivisht në metra dhe ton;
  - (ii) llogaritjes së kapacitetit operativ vjetor të planifikuar të Mbeturinave të Ngurta Komunale të cilat duhet të hudhen në deponi dhe të shprehura respektivisht në metra dhe ton; dhe
  - (iii) llogaritjes së kapacitetit operativ ditor të planifikuar të Mbeturinave të Ngurta Komunale të cilat duhet të hudhen në deponi dhe të shprehura respektivisht në metra dhe ton; dhe
- (e) Përshkrimin e detajizuar për cilindro ndryshim fizik tjetër të propozuar për pronën; dhe
- (f) Për cilëndo Deponi të Mbeturinave të përfunduar, bashkë me Aplikacionin Aplikuesi duhet të ofrojë pakon komplete të vizatimeve të “gjendjes faktike”; dhe
- (g) Aplikuesi duhet të ofrojë pakon e plotë të vizatimeve “sipas projektit”, për cilëndo Deponi të Mbeturinave qoftë ajo në fazën e planifikimit ose në fazën e ndërtimit.

Neni 26: Lokacioni dhe Përshkrimi i Deponisë së Mbeturinave

- 26.2 Aplikuesi duhet të ofrojë përshkrimin e pronës në të cilën është ndërtuar Deponia e Mbeturinave në kushtet e relacioneve të saja me tokën përreth, ujërrjedhave dhe të shtëpiave që gjinden në distancë më të vogël se pesëqind (500) metrave nga kufijtë e rrethuar ose të jashtëm të pronës. Vizatimet në përpjesë dhe dimensione të përshtatshme duhet të ofrohen bashkë me përshkrimin përmendur.
- 26.3 Aplikuesi duhet të ofrojë skicën në përpjesë dhe dimensione të përshtatshme që paraqet topografinë, gjeologjinë dhe vegjetacionin (jetën bimore) të hasur në pronë dhe trojet në afërsi.
- 26.4 Aplikuesi duhet të ofrojë informacionin në vijim duke përfshirë skicën në përpjesë dhe dimensione të përshtatshme që ka të bëjë me praninë e masave ujore dhe shtresave ujëmbajtëse në pronë dhe trojet në afërsi:
  - (a) Lokacionin e të gjitha ujërrjedhave, nëse ka, në pronë ose në afërsi të saj, ose dhe vepra ujëmarrëse në të cilët prona mund të drenohet duke përfshirë kanalet kulluese, hapësirën e jashtme, grykat e thella, kanalet e rrebesheve, dhe cilatdo përrocka; dhe
  - (b) Lokacionin i çfarëdo akuiferi të njohur të ujërave nëntokësore, në pronën e deponisë ose afër pronës; dhe
  - (c) Lokacionin e të gjitha shpimeve dhe puseve të ujit të vendosur në ose përbrenda një (1) kilometri prej kufirit të pronës, duke përfshirë përshkrimin e shfrytëzimit të tanishëm të atyre puseve; dhe

- (d) Përshkrimi i shfrytëzimit të tokës para se të jetë caktuar për ose të jetë shfrytëzuar për Deponimin e Mbeturinave.

Neni 27: Pajisja e Vendit të Deponisë së Mbeturinave

Aplikuesi duhet të sigurojë listën e pajisjeve kryesore të cilat do të përdoren në Kompleksin e Deponimit të Mbeturinave siç është e detajizuar në Formularin e Kërkesës të Licencimit të Deponisë së Mbeturinave.

Neni 28: Tarifat e Shërbimit

Aplikuesi duhet të ofrojë listën e Tarifave të Shërbimit qoftë të atyre që janë në fuqi që nga data në të cilën është dorëzuar Aplikacioni ose të propozuara për periudhën dymbëdhjetë (12) muajshe pas datës së nismës së punës ose nëse është deponi e re Tarifat e Shërbimeve të propozuara së paku për periudhën dymbëdhjetë (12) muajshe pas datës në të cilën ka filluar operimi.

Neni 29: Struktura Operative

- 29.1 Aplikuesi duhet të ofrojë skemën e detajizuar organizative të Deponisë së Mbeturinave që qartë identifikon pozitat e ndryshme të punës me orar të plotë si dhe marrëdhëniet e tyre përkatëse menaxhuese dhe mikqyrëse të cilat qartazi duhet të tregojnë numrin e të punësuarve që janë të caktuar për secilën pozitë, e cila duhet të përfshijë:
- (a) Menaxherin Operativ të Deponisë së Mbeturinave
  - (b) Mbikqyrësi i Deponisë së Mbeturinave
  - (c) Kryepunëtori i Lartë i Deponisë së Mbeturinave
  - (d) Kryepunëtori i Ndërrimit i Deponisë së Mbeturinave
  - (e) Punëtor i Lartë i Peshores
  - (f) Punëtor i Sinjalizues
  - (g) Punëtor krahu (fizik)
  - (h) Portieri
  - (i) Zyrtari i Lartë i Sigurimit
  - (j) Roja e Sigurimit
  - (k) Punëtor për Shpërndarjen e Naftës dhe Lubrifikantëve
  - (l) Operues i Paisjeve të Rënda (sipas llojit të paisjes)
  - (m) Mekanik i Mirëmbajtjes dhe salduesit
  - (n) Sekretar – recepcionist
  - (o) Punëtor për Shërbimet ndaj Konsumatorëve
  - (p) Zyrtar i Prokurimit
- 29.2 Aplikuesi duhet të ofrojë përshkrimin e detajizuar të procedurave të cilat duhet të përdoren për të pranuar, marrur dhe për të vëzhguar Mbeturinat e Ngurta Komunale të pranuar dhe të cilat së paku duhet të përfshijnë:
- (a) Procedurat për pranimin e mjeteve transportuese që bartin mbeturina në portën hyrëse të Kompleksit; dhe
  - (b) Procedura për verifikim vizual në saje të pranueshmërisë; dhe

- (c) Procedura për peshimin (matjen në peshore) e mjeteve transportuese që bartin mbeturina të cilat hyjnë dhe dalin, duke përfshirë përgatitjen dhe dërgimin e fletë peshores; dhe
  - (d) Procedura për mbajtjen e shënimeve.
- 29.3 Aplikuesi duhet të ofrojë procedurën e cila duhet të përdoret për klasifikimin dhe riciklimin e produkteve të mbeturinave në vend dhe përshkrimin e të gjitha masave të mundshme ose procedurave operative të cilat do të ndihmonin në lehtësimin e ndarjes së llojit të mbeturinave të pranuar në vend.
- 29.4 Aplikuesi duhet të ofrojë procedurën dhe planin operativ për operimin e vendosjes së mbeturinave dhe mbulesën ditore në secilën qeli aktive, si dhe nivelin e ngjeshjes.
- 29.5 Aplikuesi duhet të ofrojë procedurat të cilat do të vendosen për të kontrolluar kafshët, brejtësit, insektet dhe bartësit tjerë të mundshëm të sëmundjeve si dhe procedurat të cilat duhet të shfrytëzohen për të kontrolluar plehë rat në vend, në rrugët e kyqjes si dhe në tokat afër deponisë.
- 29.6 Aplikuesi duhet të ofrojë përshkrimin e planit për mbrotje kundër zjarrit i cili duhet të përdoret për të parandaluar, kontrolluar dhe shuar zjarret dhe duhet të përfshijë përshkrimin e trajnimit për të luftuar zjarrin i cili duhet të u ofrohet të punësuarve, si dhe listën e pajisjeve kundër zjarrit të cilat gjat tërë kohës duhet të jenë të vendosura në deponi.

## **Kapitulli 5: Konsideratat për Mjedisin**

### Neni 30: Ndikimet në Mjedis

- 30.1 Aplikuesi duhet të ofrojë përshkrimin e masave dhe mjeteve, të cilat duhet të instalohen, dhe implementohen në Deponinë e Mbeturinave për të zvogëluar cilatdo ndikime negative në mjedis, të cilat në minimum duhet të përfshijnë:
- (a) Planin dhe masat të cilat duhet të përdoren për të menaxhuar ujërat sipërfaqësor nga rreshjet për tu derdhur në Deponinë e Mbeturinave duke përfshirë listën dhe lokacionin e pajisjeve dhe infrastrukturës e cila duhet të përdoret për parandalimin e ndotjes dhe instrumentet monitoruese të rrjedhës;
  - (b) Plani për grumbullimin dhe përpunimin e ujit të kontaminuar dhe kullimeve që burojnë nga Deponia e Mbeturinave.
- 30.2 Aplikuesi duhet të ofrojë kopjen e studimit të ndikimit në mjedis të bërë për Deponinë të Mbeturinave dhe aprovimin nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor.

### Neni 31: Plani i Mbylljes së Deponisë së Mbeturinave

- 31.1 Aplikuesi duhet të parashtroj kopjen e planit për mbylljen e Deponisë së Mbeturinave që ka të bëjë me:
- (a) Mbylljen e cilësdo qeli aktive si pjesë e aktiviteteve të rregullta operative; dhe
  - (b) Mbylljen e Deponisë së Mbeturinave në momentin kur të arrijë kapacitetin e plotë ose përherë të mbyllet për cilëndo qoftë arsye.
- 32.2 Plani përfundimtar i Deponisë së Mbeturinave duhet të përfshijë detajet e aktiviteteve për përkujdesje të mëtejshme dhe monitoruese të Deponisë së Mbeturinave pasi që një herë e përgjithmonë të mbyllet.

## Kapitulli 6: Sigurimi dhe Garancionet Financiare

### Neni 32: Sigurimi i Detyrimeve të Përgjithshme

- 32.1 Operatori i Deponisë së Mbeturinave duhet të mbajë në fuqi dhe në veprim gjatë gjithë kohës sigurimin e hollësishëm të detyrimeve të përgjithshme publike i lëshuar nga institucioni i sigurimit i autorizuar për këtë që llim në Kosovë dhe i cili së paku duhet të mbulojë:
- (a) Objektet dhe përgjegjësinë e operimit;
  - (b) Detyrimet kontraktuale;
  - (c) Rreziqet nga zjarri dhe shpërthimet;
  - (d) Lëndimet personale dhe vdekja;
  - (e) Sigurimin e detyrimeve të automjeteve motorike; dhe
  - (f) Sëmundjet, paaftësia për punë dhe/ose vdekjen e ndonjërit prej punëtorëve të tij për shkak të rreziqeve në profesion; dhe
  - (g) Sigurimin e Detyrimeve Publike
- 32.3 Mbulimi i sigurimit duhet të përfshijë të gjithë të punësuarit dhe të gjitha mjetet transportuese vetanake, të huazuara ose lëshuara me qira që shfrytëzohen nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave për të përmbushur obligimet e tij që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave.
- 32.4 Aplikuesi, bashkë me Aplikacionin, duhet të ofrojë dëshminë e dokumentuar për mbulimin e sigurimit për secilin element të paraqitur në nën-Nenin 32.1 të lartëshënuar, në formë të certifikatës për sigurim, duke përfshirë faqet e deklaratës së polisës që qartë identifikojnë kompaninë e sigurimit, datat efektive të polisës, kufijtë e përgjegjësisë dhe emrin e entitetit të siguruar.
- 32.5 Operatori i Deponisë së Mbeturinave duhet menjëherë të ndërprejë ofrimin e Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave pas anulimit ose shuarjes së sigurimit të kërkuar në bazë të nën-Nenit 32.1 të lartëshënuar. Komunitet e goditura nga ky rast duhet menjëherë të informohen për këtë dukuri.

### Neni 33: Garancioni i Zbatimit

- 33.1 Operatori i Deponisë së Mbeturinave duhet të mbajë në fuqi të plotë gjatë gjithë kohës Garancionin e Zbatimit të lëshuar nga institucioni financiar i licencuar për këtë qëllim në Kosovë dhe i cili kolektivisht duhet të jetë në favor të Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të autorizuar për të shfrytëzuar Deponinë e Mbeturinave.
- 33.2 Vlera e Garancionit të Zbatimit duhet të jetë në vlerën tridhjetëetë për qind (33%) të të hyrave bruto vjetore të pritshme të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave.
- 33.3 Në rast se Operatori i Deponisë së Mbeturinave nuk është në gjendje ose dështon për të ofruar Shërbimet për Deponimin e Mbeturinave, Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të autorizuar për të shfrytëzuar pronën, duhet të kenë kolektivisht mundësinë për mbulimin e shpenzimeve dhe të kompenzimit nga Garancioni i Zbatimit për cilatdo shpenzime shtesë të cilat kanë mundur të pësohen në lidhje me transportimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale tek një tjetër Kompleks për Deponimin e Mbeturinave.



## **Kapitulli 7: Dokumentet Shoqëruese të Nevojshme**

Pë rpos dokumenteve që duhet të parashtrohet me Aplikacionin në vijim të kësaj Rregulle, Aplikuesi duhet poashtu të ofrojë Dokumentet dhe Informatat të renditura në këtë Kapitull

### Neni 34: Biografia e secilit Menaxher të Lartë

Aplikuesi duhet të parashtrrojë së bashku me Aplikacionin edhe biografinë e secilit prej menaxherëve të lartë si në vijim:

- (a) Kryesuesit të Bordit Mbikqyrës; dhe
- (b) Drejtorit Menaxhues ose Menaxhuesit të Përgjithshëm sipas rastit; dhe
- (c) Zyrtarit të Lartë Financiar; dhe
- (d) Menaxherit të Deponisë së Mbeturinave.

### Neni 35: Dokumentet e kërkuara të biznesit së bashku me Aplikacionin

Aplikuesi bashkë me Aplikacionin duhet të parashtrrojë dokumentet e biznesit si në vijim:

- (a) Kopjen e statutit ose dokumenteve e themelimit që ligjërisht e themelojnë ose e inkorporojnë Aplikuesin; dhe
- (b) Organogramin i cili tregon qartë dhe identifikon të gjitha nivelet e funksioneve duke filluar nga Bordi Mbikqyrës; dhe
- (c) Kopjen e Certifikatës për Regjistrimin e Biznesit që është në fuqi dhe valide e lëshuar për Aplikuesin; dhe
- (d) Kopjen e Certifikatës për Regjistrimin e TVSH-së të lëshuar për Aplikuesin; dhe
- (e) Konfirmim me shkrim nga Zyrtari i Lartë Financiar i Aplikuesit për Licencë të Shërbimit se të gjitha pagat e punëtorëve janë paguar në mënyrë të rregullt sipas marrëveshjes me punëtorët e përmendur; dhe se tatimi mbi të ardhurat dhe shumat që kanë të bëjnë me fondet e pensioneve të ruajtura në mirëbesim nga punëdhënësi në emër të punëtorëve janë dërguar në autoritetet e caktuara fiskale sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovës; dhe
- (f) Një kopje të kompletit të fundit të deklaratave financiare, të audituara nëse janë në dispozicion. Deklaratat financiare duhet të mbulojnë komplet periudhën fiskale duke i paraprirë datës në të cilën është dorëzuar Aplikacioni për Licencë të Shërbimit, si dhe deklaratat financiare për secilin muaj duke mbuluar periudhën që fillon në ditën e parë të muajit duke vazhduar deri në fund të periudhës së përmendur fiskale deri në ditën e fundit të muajit që i paraprinë asaj gjatë së cilës është dorëzuar Aplikacioni për Licencë të Shërbimit te Rregullatori; dhe
- (g) Një kopje e deklaratës bankare për të gjitha llogaritë bankare të Aplikuesit për periudhën që mbulon gjashtë (6) muaj duke i paraprirë datës në të cilën është dorëzuar Aplikacioni; dhe
- (h) Kopjen e deklaratave financiare për vitin aktual dhe të Kopjen e deklaratave financiare të buxhetuara për dy vitet e ardhshme fiskale; dhe
- (i) Dëshminë e dokumentuar detalisht për të gjitha investimet e bëra ose që duhet të bëhen në funksion të zhvillimit të plotë të Kompleksit për Deponimin e Mbeturinave dhe sjelljen e tij në shkallën operative; dhe

- (j) Detajet për cilatdo investime të planifikuara në të ardhmen që duhen të bëhen në Kompleksin për Deponimn e Mbeturinave gjatë periudhës tri (3) vjeçare pas datës në të cilën është dorëzuar Aplikacioni.

Neni 36: Tatimi mbi Pronën, Tatimet Tjera të Aplikueshme, Faturat e Ndërmarrjeve si dhe Detyrimet që kanë të bëjnë me to

- 36.1 Aplikuesi së bashku me Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave duhet të dorëzojë dokumentet lidhur me ndërmarrjet publike dhe tatimet, si vijon:
- (a) Dëshmia e dokumentuar që qartë demonstroi se Aplikuesi është i rregulltë me pagesën e Faturave të tij për ujë, rrymë elektrike dhe telefon duhet gjithashtu të paraqitet në momentin kur të dorëzohet Aplikacioni. Dëshmia e dokumentuar duhet të jetë në formë të letrës nga ndërmarrja për shërbime publike në fjalë që qartë shfaq se Aplikuesi i është i rregulltë në pagesën e të gjitha Faturave ndaj ndërmarrjeve për shërbime publike relevante ose kopjen e faturimit të fundit nga ndërmarrjet për shërbime publike duke i paraprirë datës së dorëzimit të Kërkesës që tregon vlerën “zero” lidhur me cilatdo Fatura të mëparshme;
- (b) Dëshmia e dokumentuar që demonstroi qartë se Aplikuesi është i rregulltë në pagesat e faturave të ujit, rrymës elektrike dhe telefonit duhet të prezantohet në momentin e dorëzimit të Kërkesës. Dëshmia e dokumentuar duhet të jetë në formë të letrës nga ndërmarrjet në fjalë që tregon qartë se Aplikuesi i Licencës së Shërbimit është i rregulltë në pagesën e të gjitha faturave ose kopjen e faturës së fundit duke i paraprirë datës së dorëzimit të Aplikacionin për Licencë e cila tregon vlerën “zero” në bilanc sa i përket cilatdo faturave të mëparshme.
- (c) Dëshmia e dokumentuar që demonstroi qartë se Aplikuesi është i rregulltë në pagesën e faturave tjera tatimore për të cilat Aplikuesi është i detyruar të përfshijë TVSH-në, tatimin mbi të hyrat dhe tatimet tjera të definuara me ligj si të maturuara dhe të pagueshme tek autoriteti kompetent duhet të ofrohet.
- 36.2 Në rast se nuk është i rregulltë me pagesat e faturave për tatimin mbi pronën dhe/ose cilëndo nga faturat e ndërmarrjeve për shërbime publike ose cilëndo obligim ndaj tatimeve tjera që zbatohen në Kosovë, duhet të ofrohet shpjegimi dhe arsyet, konfirmimi i shumës së borxhit dhe përkrahimi i masave korrektuese që duhen të ndërmerren për secilën instancë në të cilën Aplikuesi nuk është i rregulltë.

**PJESA 3: SHQYRTIMI I APLIKACIONIT DHE LËSHIMI I LICENCËS PËR SHËRBIME PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE**

**Kapitulli 1: Shqyrtimi i Aplikacionit**

Neni 37: Shqyrtimi i Përgjithshëm i Kërkesës dhe Dokumenteve Shoqëruese

Rregullatori duhet të kompletojë shqyrtimin e përgjithshëm të Aplikacionit së dorëzuar dhe të dokumenteve shoqëruese përkatëse si në vijim:

- (a) Rregullatori duhet të sigurojë se Aplikacioni e dorëzuar nga Aplikuesi është kompletuar në tërësi dhe se janë përfshirë informatat e kërkuara dhe dokumentet shoqëruese. Rregullatori duhet të regjistrojë rezultatet e shqyrtimit të përgjithshëm të Kërkesës në Listën Kontrolluese Administrative të Kompletueshmë risë të dhënë në shtojcën e kësaj Rregulle; dhe

- (b) Rregullatori duhet të informojë me shkrim Aplikuesin brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës për cilëndo informatë që mungon ose është e pakompletuar dhe që Aplikacioni do të mbahet pezull përderisa të ofrohen ato dokumente ose informata që mungojnë, për një periudhën që nuk tejkalon tridhjetë (30) Ditë të Punës, pas së cilës dokumentet e Kërkesës duhet të i kthehen Aplikuesit. Në rast se ndodhë një gjë e tillë shuma e plotë e Taksës së Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave duhet të konfiskohet dhe duhet të ngel tek Rregullatori.

#### Neni 38: Pamundësia për të Ofruar Informatat e Kërkuara

Aplikuesi duhet të ofrojë arsyetimin me shkrim tek Rregullatori lidhur me pamundësinë e tij të ofrojë cilëndo prej informatave ose dokumenteve të kërkuara që duhet ta shoqërojë Aplikacionin dhe të ofrojë planin e afatizuar të veprimit të kompletuar me masat korrektuese për korrigjimin e situatës.

#### Neni 39: Shqyrtimi i detajizuar i Kërkesës

Menjëherë pas kalimit të instancës kur Aplikacioni për Licencë të Shërbimit konsiderohet e pranueshme, Rregullatori duhet të vazhdojë të përmbushë dhe kompletojë brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës një shqyrtim teknik më gjithëpërfshirës dhe më objektiv lidhur me:

- (a) Saktësinë dhe tërësinë e informatave të ofruara në Aplikacion për Licencë të Shërbimit dhe në dokumentet përkatëse shoqëruese;
- (b) Kapacitetit të menaxhmentit dhe aftësisë operative të Aplikuesit për të drejtuar dhe operuar Kompleksin për Deponimin e Mbeturinave me kualitet të nivelit të pranueshëm, me besueshmëri dhe siguri të duhur për një kosto të përballueshme për Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe për kushtet ekonomike ekzistuese në Kosovë; dhe
- (c) Kapacitetit financiar të Aplikuesit për sa i përket mirëmbajtjes dhe vazhdimit të punës dhe menaxhimit të Deponisë së Mbeturinave për periudhën që duhet të mbulohet nga Licenca për Shërbime për Deponimin e Mbeturinave; dhe
- (d) Vlerësimi i efekteve të dhënies së Licencës të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave që ndërlidhen me mungesën e cilitdo dokumenti ose informate që mungon si dhe masat korrektuese të propozuara në Nenin 38 të lartëshënuar;

#### Neni 40: Kërkuarja e Informatave Plotësuese

Aplikuesi plotësisht duhet të bashkëpunojë me Rregullatorin që me përpikëri të ofrojë cilatdo informata dhe dokumente shtesë që në mënyrë të arsyeshme kërkohen nga Rregullatori për të shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të duhur Aplikacionin.

### **Kapitulli 2: Lëshimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**

#### Neni 41: Lëshimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Rregullatori duhet të lëshojë Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të Aplikuesit i suksesshëm brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës nga data në të cilën është kompletuar shqyrtimi i detajizuar dhe rezultatet e shqyrtuara kanë nxjerrun vlerësimin se arsyetojnë lëshimin e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave për Aplikuesin i cili ka demonstruar se plotëson kushtet si në vijim:

- (a) Ka dërguar paratë e Taksës së Kërkesës për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
- (b) Ka dorëzuar Aplikacionin e kompletuar dhe dokumentet e kërkuara;
- (c) Ka demonstruar nëpërmes të parashtrimit të Aplikacionit se ka ndershmëri financiare dhe kapacitet teknik dhe ekonomik për të mirëmbajtur dhe vazhduar punën dhe menaxhimin në nivel që kërkohet në Kushtet e Licencës të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të lëshuar nga Rregullatori;
- (d) Ka demonstruar nëpërmes të parashtrimit të Aplikacionit se ka zotësi menaxhuese dhe ekspertizë për të operuar dhe menaxhuar Kompleksin për Deponimin e Mbeturinave sipas Standardeve të Shërbimit të lëshuara nga Rregullatori;
- (e) Ka demonstruar nëpërmes të parashtrimit të Aplikacionit se ka paisje adekuate dhe burime të mjaftueshme për mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre në nivel të duhur për të operuar dhe menaxhuar Kompleksin për Deponimin e Mbeturinave sipas Standardeve të Shërbimit të lëshuara nga Rregullatori;
- (f) Ka marrë të gjitha lejet e nevojshme, pëlqimet dhe autorizimet tjera nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe nga të gjitha autoritetet tjera të caktuara dhe ka ofruar dëshminë se është në pajtim me Aplikacionit e atyre lejeve, pëlqimeve dhe autorizimeve;

Neni 42: Mos-Diskriminimi

Rregullatori nuk duhet të bëjë diskriminim ndaj asnjë Aplikuesi në procedurat e tij për lëshimin e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të Aplikuesi pamvarë sishit prej racë s, etnicitetit, karakteristikave kulturore ose ekonomike, prejardhjes së Aplikuesit, anëtarëve të bordit ose punëtorëve të tij, ose të zonë s gjeografike përbrenda të cilës ndodhet Aplikuesi.

**PJESA 4: LICENCA E SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE**

**Kapitulli 1: Përmbajtja e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**

Neni 43: Përmbajtja e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave e lëshuara nga Rregullatori së paku duhet të specifikojë ose duhet të përfshijë sa vijon:

- (a) Certifikatën e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
- (b) Afatin për të cilin është lëshuar Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
- (c) Taksën për Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave e cila duhet të paguhet nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave;
- (d) Emrat e Komunave që duhet të u ofrohen shërbimet nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave;
- (e) Emri i Komunës përbrenda të cilës është përcaktuar vendndodhja e Deponisë së Mbeturinave si dhe ofroimi i përshkrimit të kufijve territorial të regjionit të zënë prej Deponisë së Mbeturinave;

- (f) Përshkrimin e Regjionit të Shërbimit duke përfshirë zonën gjeografike dhe kufijtë territorial;
- (g) Emrat e Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të cilët do të jenë të autorizuar të transportojnë dhe shkarkojnë Mbeturinat e Ngurta Komunale;
- (h) Përshkrimin e llojit të Mbeturinave të Ngurta Komunale për të cilët do të autorizohet pranimi nga Deponina e Mbeturinave;
- (i) Deklaratën që konfirmon se Operatori i Deponisë së Mbeturinave do të detyrohet që të pranoj Mbeturinat e Ngurta Komunale të autorizuar nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që janë të vendosur dhe punojnë përbrenda Regjionit të Shërbimit;
- (j) Listën e raporteve që duhet të përgatiten nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave për Rregullatorin;
- (k) Listën e shënimeve financiare të cilat Operatori i Deponisë së Mbeturinave kërkohet ti mbajë si dhe kushtet nën të cilat ato duhet të mbahen;
- (l) Referencat në Standardet e Shërbimit të cilat Operatori i Deponisë së Mbeturinave do të jetë i obliguar të i mirëmbajë; dhe
- (m) Listën e Tarifave të Shërbimeve të cilat Operatori i Deponisë së Mbeturinave do të kërkohet të i përdorë.

## **Kapitulli 2: Obligimet e Operatorit të Deponisë së Mbeturinave**

### Neni 44: Obligimet e të gjithë Operatorëve të Deponive të Mbeturinave

- 44.1 Operatori i Deponisë së Mbeturinave është i obliguar që tu përshtatet të gjitha Kushteve Licencuese të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave dhe çfarëdo kushteve shtesë të cilat mund të kërkohen dhe lëshohen nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 44.2 Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave e lëshuar nga Rregullatori qartë duhet të indentifikojë obligimet e Operatorit të Deponisë së Mbeturinave si në vijim:
  - (a) Të ofrojë dhe të mirëmbajë Shërbimet për Deponimin e Mbeturinave në nivelin që parashihet në Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
  - (b) Rregullisht dhe pa përjashtime të pajisë me Faturë të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Konsumatorët që pranojnë Shërbimet për Deponimin e Mbeturinave;
  - (c) Të ofrojë raporte për Rregullatorin sipas Aplikacionive për shpalosjen e raporteve dhe informatave të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe;
  - (d) Të pranojë vetëm Mbeturina të Ngurta Komunale të cilat lejohen sipas Licencës për Deponimin e Mbeturinave; dhe
  - (e) Të operojë dhe menaxhojë Deponinë e Mbeturinave sipas Aplikacioneve të vendosura në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.
- 44.3 Operatori i Deponisë së Mbeturinave gjithashtu duhet të paguajë të Rregullatori Taksën Vjetore për Licencë, e cila duhet të përcaktohet si në vijim:
  - (a) Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Zhvillim dhe Rindërtim Ekonomik në pajtim me rekomandimet nga Rregullatori, duhet të

përcaktojë shumën e Taksës Vjetore të pagueshme për Licencë në bazë të këtij Neni; dhe

- (b) Taksa Vjetore për Licencë e maturuar dhe e pagueshme nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave për Rregullatorin nuk duhet të tejkalojë një e gjysmë përqind (1.5%) të qarkullimit bruto të raportuar nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave në konton e audituara të fitimit ose të humbjes; dhe
  - (c) Taksa Vjetore për Licencë të deponimit duhet të vendoset duke u bazuar në shpenzimet të cilat Rregullatori i parasheh që do të shkaktohen në lidhje me lëshimin dhe monitorimin e Licencave të Shërbimit, siç janë të prezantura në planin vjetor të veprimit apo në buxhetin vjetor të përgatitur nga Rregullatori për vitin kalendarik në të cilin ajo Taksa Vjetore për Licencë bëhet e maturuar.
- 44.4 Operatori i Deponisë së Mbeturinave duhet të paguajë Taksën Vjetore për Licencë në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta tek Rregullatori, ku kësti i parë është i maturuar dhe i pagueshëm në ditën e parë të punës së muajit kalendarik pas datës në të cilën pjesa e maturuar e Taksës Vjetore për Licencë bëhet e pagueshme dhe në ditën e parë të punës të secilit muaj vijues mëpastaj.

## **PJESA 5: REFUZIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE**

### Neni 45: Refuzimi për të lëshuar ose Ripërtërirë Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 45.1 Rregullatori mund të refuzojë të aprovojë ose të ripërtërirë Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave në bazë të:
- (a) dështimit nga ana e Aplikuesit që të ofrojë informacionet e duhura brenda kufijve të caktuar kohor;
  - (b) vlerësimit nga ana e Rregullatorit se Aplikuesi do të jetë i paaftë për të ofruar Shërbimet për Deponimin e Mbeturinave në nivelin e duhur të Standardeve të Shërbimit me besueshmëri dhe siguri të kërkuar;
  - (c) dështimit nga ana e Aplikuesit për të marrë autorizimet e nevojshme ose licencat nga autoritetet tjera kompetente siç kërkohet me ligj; dhe
  - (d) arsytiveve tjera të justifikuara që mund të arsyetohen në Kushtet e Licencës për Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave.
- 45.2 Në rast të refuzimit për të lëshuar ose ripërtërirë Licencën e Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave, Rregullatori duhet të informojë më shkrim Aplikuesin brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës se ka marrë një vendim të tillë dhe të ofrojë arsyet për marrjen e atij vendimi.

## **PJESA 6: RIPËRTËRIRJA OSE TRANSFERI I LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN TË MBETURINAVE**

### **Kapitulli 1: Ripërtërirja ose Transferi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**

#### Neni 46: Ripërtërirja e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 46.1 Operatori i Deponisë së Mbeturinave i licencuar nga Rregullatori duhet të parashtojë Aplikacionin për ripërtërirjen e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave së paku tre (3) muaj kalendariq para datës në të cilën skadon afati i Licencës ekzistuese të Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave.
- 46.2 Aplikacioni për ripërtërirjen e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave duhet të bëhet në Formularin e Aplikacionin për Licencë së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave që është e ofruar në shtojcën e kësaj Rregulle dhe sipas procedurës së paraqitur në këtë Rregull.
- 46.3 Rregullatori duhet të ripërtërijë Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave për Aplikuesin e suksesshëm brenda tridhjetë (30) Ditëve të Punës nga data në të cilën është përfunduar shqyrtimi i detajizuar sipas procedurave të krijuara në Neni 41 dhe Neni 42 të lartëshënuar dhe rezultatet e shqyrtuara të vlerësuara si të pranueshme sa i përket:
- (a) plotësimin të kushteve të paraqitura në këtë Rregull sa i përket parashtrimin të Aplikacionin për Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
  - (b) demonstrimin nëpërmes të parashtrimin të kërkesës për ripërtërirjës të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave se ka plotësuar Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave në licencën e tij paraprake;
  - (c) të dëmonstrojës se të gjitha licencat, lejet, pëlqimet dhe autorizimet tjera të domosdoshme nga të gjitha autoritetet e caktuara duhet të jenë të vlefshme për kohë zgjatje të barabartë ose që tejkalon periudhën kohore për të cilën është ripërtërirë Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave; dhe
  - (d) Aplikacionive tjera të kësaj Rregulle që mund të jenë të aplikueshme.

#### Neni 47: Transferi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave e lëshuar nga Rregullatori në bazë të kësaj Rregulle nuk duhet të transferohet ose në formë tjetër të ipet të cilado palë e tretë pa pëlqim të qartë dhe me shkrim nga ana e Rregullatorit.

## **PJESA 7: NDRYSHIMET, SHUARJA DHE REVOKIMI I LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE**

#### Neni 48: Ndryshimet, Plotësimet, ose Zëvendësimet në Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Rregullatori duhet të ketë të drejtë të ndryshojë, plotësojë ose zëvendësojë cilatdo Kushte të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të vendosura në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave në vijim të shqyrtimit të atyre kushteve pas njoftimit me shkrim të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave prej së paku tridhjetë (30) Ditë të Punës. Njoftimi i tillë qartë duhet të theksojë natyrën, zgjatjen, dhe kohën e hyrjes në fuqi të atij

ndryshimi, plotësimi ose zëvendësimi të cilatdo Kushteve të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.

Neni 49: Ndryshimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Rregullatori mund të ndryshojë Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave për të:

- (a) korrigjuar gabimet drejtshkrimore;
- (b) pranuar ndryshimet e aprovuara në stafin menaxhues të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave;
- (c) pranuar aprovimin e ndryshimit në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të bëra nga ana e Operatorit të Deponisë së Mbeturinave;
- (d) pranuar aprovimin ose Aplikacionit e dorëzuara nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave tek agjensionet tjera për autorizim;
- (e) pranuar aprovimin e ndryshimit të bërë në Regjionin e Shërbimit;
- (f) pranuar modifikimet tjera të aprovuara nga Rregullatori.

Neni 50: Shqyrtimi i Kualifikimeve të Drejtorit Menaxhues dhe Menaxherit Operativ të Deponisë së Mbeturinave

- 50.1 Para emërimit të Drejtorit Menaxhues dhe Menaxherit Operativ të Deponisë së Mbeturinave që nuk janë të njëjtit të përmendur në Aplikacionin për Licencë të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave dhe më pas në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, Kryesuesi i Bordit Mbikqyrës duhet t'ia dërgojë Rregullatorit kopjen e biografisë për secilin kandidat tjetër të propozuar, në formatin dhe përmbajtjen siç është e paraqitur në shtojcën e kësaj Rregulle.
- 50.2 Rregullatori duhet të shqyrtojë kualifikimet dhe përvojën e kandidatëve tjerë të propozuar për të siguruar kompetencën teknike, operative dhe menaxhuese si dhe duhet ti ofrojë përgjigjen me shkrim Bordit Mbikqyrës të entitetit që ka dorëzuar Aplikacionin brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës nga data në të cilën Rregullatori e ka pranuar Aplikacionin.

Neni 51: Informimi i Rregullatorit për Ndryshimet e Rëndësishme

- 51.1 Operatori i Deponisë së Mbeturinave duhet të informojë me shkrim në detaje Rregullatorin brenda pesë (5) Ditëve të Punës për çfarëdo ndryshimi të rëndësishëm të të dhënave nga ato të dorëzuara ose të bashkangjitura në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.
- 51.2 Rastet si në vijim, pa kufizime, konsiderohen që përbëjnë ndryshime të rëndësishme të situatës së Operatorit të Deponisë së Mbeturinave nga ajo e ofruar në Aplikacion:
  - (a) ndryshimet e rëndësishme të bëra ose anulimet, pezullimet ose refuzimet e dhënies ose ripërtëritjes të cilësdo leje, pëlqimit ose autorizimit të marrë nga agjensionet tjera ose autoriteteve kompetente;
  - (b) zgjerimi ose reduktimi i rëndësishëm i kapacitetit të Deponisë ose kufizimet në shfrytëzimin e Deponisë të përdorura për ofrimin e Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave;
  - (c) ndryshim i rëndësishëm në Zonën e Shërbimit;
  - (d) Ndryshimet e rëndësishme në pozitën ekonomike dhe financiare të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave;



- (e) reduktimi i dukshëm ose rritja në pasuritë dhe/ose përgjegjësitë e Operatorit të Deponisë së Mbeturinave;
- (f) ndryshimi në pronësinë efektive dhe/ose në kontrollin menaxhues të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave;

## **Kapitulli 2: Përfundimi, Revokimi ose Dorëzimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**

### Neni 52: Përfundimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave duhet të përfundojë para:

- (a) ditës së fundit të periudhës për të cilën është lëshuar; ose
- (b) ditës në të cilën ajo është revokuar nga Rregullatori; ose
- (c) ditës në të cilën ajo është dorëzuar.

### Neni 53: Revokimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 53.1 Rregullatori mund të revokojë Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave në bazë të Nenit 7-të të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 e datës 26 Nëntor 2004, mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe të Mbeturinave.
- 53.2 Rregullatori gjithashtu mund të revokojë Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave nëse:
- (a) Ai dështon të ofrojë Shërbime për Deponimin e Mbeturinave brenda një (1) viti nga data në të cilën është lëshuar Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
  - (b) pranon çfarëdo lloji ose kategorie të produkteve të mbeturinave për të cilat nuk është i licencuar të bëjë një gjë të tillë;
  - (c) pranon çfarëdo lloji ose kategorie të produkteve të mbeturinave në çfarëdo sasive nga kufijtë që janë jashtë Regjionit të Shërbimit për të cilin është i licencuar;
  - (d) pranon çfarëdo lloji ose kategorie të produkteve në çfarëdo sasive nga kufijtë jashtë Kosovës;
  - (e) Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor revokon licencën e cila i është lëshuar Operatorit të Deponisë së Mbeturinave; dhe
  - (f) revokohet cilado Licencë e kërkuar për të mirëmbajtje operimin nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave dhe e cila i është lëshuar nga cilido autoritet kompetent i Kosovës.
- 53.3 Operatori i Deponisë së Mbeturinave, të cilit i revokohet Licenca e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, mund të ankohet ndaj vendimit të rregullatorit në bazë të Nenit 63 të mëposhtëshënuar.

### Neni 54: Dorëzimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 54.1 Operatori i Deponisë së Mbeturinave mund të dorëzojë Licencën e vet të Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave duke e njoftuar me shkrim Rregullatorin gjatë (6) muaj më herët.
- 54.2 Njoftimi me shkrim i kërkuar në bazë të nën-Nenit 54.1 të lartëshënuar duhet të nënshkruhet nga Kryesuesi i Bordit i Operatorit të Deponisë së Mbeturinave.

## **PJESA 8: MARRËVESHJA PËR KUSHTET E LICENCËS SË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE**

### Neni 55: Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 55.1 Rregullatori mund të lidhë marrëveshjen me shkrim me cilindo Operator të Deponisë së Mbeturinave me qëllim të ndërrimit, ndryshimit, dhe/ose plotësimit të cilatdo Kushteve të Licencës për Deponimin e Mbeturinave të përcaktuara me këtë Rregull.
- 55.2 Në marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave mund të hyhet nëse janë dhënë cilatdo kushte pararendëse të përcaktuara nga Rregullatori dhe të propozuara për Operatorin e Deponisë së Mbeturinave, duke përfshirë, pa kufizime, hyrjen në marrëveshje tjera me Operatorin e Deponisë së Mbeturinave mbi:
- (a) Vendosijen, shqyrtimin dhe/ose modifikimin e cilatdo Standardeve të Shërbimit;
  - (b) Vendosijen, shqyrtimin dhe/ose modifikimin e Tarifave të Shërbimit;
  - (c) Zgjerimin e Zonës së Shërbimit;
  - (d) Zgjerimin e Deponisë së Mbeturinave;
- 55.3 Për mënjanimin e çdo dyshimi, Operatorët e Deponisë së Mbeturinave kanë të drejtë, por nuk janë të obliguar ti propozojnë Rregullatorit hyrjen në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave në pajtim me dispozitat e paraqitura në Nenin 57 të mëposhtëshënuar.

### Neni 56: Negociatat për Marrëveshjen e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 56.1 Operatori i Deponisë së Mbeturinave që dëshiron të hyjë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit duhet ti dorëzojë Rregullatorit kërkesën me shkrim me të cilën kërkon hapjen e negociatave për të hyrë në një marrëveshje të tillë duke i mbështetur arsyet se pse ai konsideron se interesi publik dhe të drejtat e tij legjitime si dhe pritjet ligjore do të shërbeheshin më së miri nëse Rregullatori do të pranonte të hyjë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit.
- 56.2 Rregullatori duhet të jep përgjigje me shkrim brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga data e pranimit të komunikatës së referuar në nën-Nenin 38.1 të lartëshënuar, qoftë lidhur me pranimin e tij të hyjë në negociata për Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave ose nëse refuzon të bëjë një gjë të tillë.
- 56.3 Nëse Rregullatori vendosë të refuzojë të fillojë negociatat për të hyrë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, ai duhet të jep arsyet e veta për atë refuzim.
- 56.4 Nëse Rregullatori pajtohet të fillojë negociatat për të hyrë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, gjithashtu duhet të i jep Operatorit të Deponisë së Mbeturinave një periudhë të arsyeshme kohore jo më pak se (30) tridhjetë ditë të punës, për të i lejuar Operatorit të Deponisë së Mbeturinave të parashtrijë te Rregullatori draftin e Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.
- 56.5 Brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës prej pranimit të draftit të Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, Rregullatori duhet të njoftojë me shkrim Operatorin e Deponisë së Mbeturinave që të përcaktoj detajet e takimit të parë në të cilin duhet të fillojnë negociatat për atë marrëveshje.

- 56.6 Rregullatori gjithashtu mund të përcaktojë periudhën maksimale kohore për realizimin e negociatave për të hyrë në Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave e cila nuk mund të jetë më pak se njëzet (20) Ditë të Punës nga caktimi i takimit të parë të negociatave sipas nën-Nenit 56.5 të lartëshënuar.
- 56.7 Për mënjanimin e çdo dyshimi, Rregullatori ka të drejtë por nuk është i obliguar të hyjë në Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave dhe, për këtë arsye, si refuzimi i tij të hyjë në negociatat për atë marrëveshje ose cilido dështim për të kompletuar në mënyrë të suksesshme negociatat e përmendura konsiderohen si vendime kontraktuese dhe jo si akte administrative ose vendime që i nënshtrohen cilitdo shqyrtim administrativ dhe/ose juridik.

Neni 57: Hyrja në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 57.1 Në rast të përfundimit të suksesshëm të negociatave të drejtuara në pajtim me Nenin 56 të lartëshënuar, Rregullatori dhe Operatori i Deponisë së Mbeturinave duhet të lidhin me shkrim Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave.
- 57.2 Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave duhet të nënshkruhet në tri (3) versione në secilën prej gjuhëve zyrtare në Kosovë, si në vijim, respektivisht:
- (a) Shqip; dhe
  - (b) Sërbisht; dhe
  - (c) Anglisht.
- 57.3 Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve në të cilat Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave është nënshkruar, versioni në gjuhën Angleze duhet të mirret si bazë.
- 57.4 Përveç nëse informata dhe/ose dokumenti mund të konsiderohet të përmbajë cilëndo informatë të privilegjuar ose konfidenciale që Rregullatori mund ta mbështesë përmes vendimit me shkrim, Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, shtojcat e saj dhe të gjitha informatat e përdorura për negociata dhe hyrja në atë marrëveshjeje duhet të publikohen apo të bëhen publike me mjetet të cilat Rregullatori mund të i përcaktojë kohë pas kohe dhe të i vë në dispozicion në çdo kohë për konsultim publik.
- 57.5 Cilatdo ndërrime, ndryshime, modifikime dhe dispozita plotësuese përkritazi me Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave duhet të kërkojnë pëlqimin nga të dy palë: Rregullatorit dhe të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave që duhet të lidhet me shkrim, të publikohet dhe të bëhet publike sipas dispozitave të nën-Neneve të lartëshënuara ose të këtij Neni.

Neni 58: Karakteri Ligjor dhe Zbatimi i Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

- 58.1 Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave konsiderohet si kontratë administrative për të gjitha objektivat ligjore të synuara duke bërë Rregullatorin të obliguar të bejë negociata, të hyjë në një marrëveshje të tillë dhe ta ekzekutojë atë me respektim të përpikët të parimeve të përgjithshme ligjore, rregullave

dhe procedurave që drejtojnë ushtrimin e të drejtave të posaçme dhe detyrave të autoriteteve publike.

- 58.2 Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave, si akt ligjor bilateral, legalisht është detyrues, imponues dhe i zbatueshëm në pajtim me kushtet e veta për të dyja palët dhe mund të, përmirësohet, zgjerohet, ndryshohet, plotësohet, shqyrtohet dhe/ose të ndërpritet vetëm nga pikëpamja e dispozitave të tija dhe ligjit të aplikueshëm në Kosovë.

Neni 59: Pajtueshmëria me Marrëveshjen për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave

Operatori i Deponisë së Mbeturinave është i obliguar të respektojë dhe tu përmbahet Kushteve të Licencës së Shërbime për Deponimin e Mbeturinave të vendosura në kushtet e përgjithshme në këtë Rregull:

- (a) Përderisa negociatat për të hyrë në Marrëveshje për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave janë të pezulluara deri në datën e hyrjes në fuqi të asaj marrëveshjeje;
- (b) Menjëherë pas ndërprerjes, anulimit, revokimit dhe/ose skadimit të Marrëveshjes për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave për sa ka të bëjë me cilëndo të drejtë dhe obligim që përmban Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave nuk bie në dakord për të mbijetuar kur të ndërpritet të jetë plotësisht në fuqi dhe efekt për çfarëdo shkak ligjor;
- (c) Në çdo pikëpamje kur Marrëveshja për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave nuk përcakton ndryshe dhe/ose kur nuk parashihet në mënyrë të veçantë në një marrëveshje të tillë.

**PJESA 9: ZBATIMI, DËNIMET DHE ANKESAT**

**Kapitulli 1: Monitorimi dhe Zbatimi i Kushteve të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**

Neni 60: Monitorimi i Respektimit

- 60.1 Rregullatori do të monitorojë përmbushjen e Kushteve të Licencës së Shërbimit të Deponimit të Mbeturinave të vendosura në këtë Rregull në bazë të raporteve të rregullta të dërguara nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave kohë pas kohë siç përcaktohet nga Rregullatori në pajtim me Nenin 61 të shënuar më poshtë .
- 60.2 Rregullatori gjithashtu do të monitorojë përmbushjen e kësaj Rregulle me anë të inspekcioneve, analizave dhe nga raportet e dërguara nga entitetet tjera dhe autoritetet publike.

**Kapitulli 2: Raportet dhe Shënimet për Kushtet e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave**

Neni 61: Shënimet dhe Raportet

- 61.1 Secili Operator i Deponisë së Mbeturinave duhet të përgatisë dhe t'ia parashtrijë raportet Rregullatorit në formën e përshkruar dhe brenda intervaleve të specifikuar nga Rregullatori kohë pas kohe.

- 61.2 Secili Operator i Deponisë së Mbeturinave duhet të parashtrojë te Rregullatori, jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik në vazhdim të mbylljes së vitit të mëparshëm kalendarik, Raportin Vjetor në formatin të cilin Rregullatori e specifikon kohë pas kohe.
- 61.3 Bilanset tre-mujore të pa-audituar duhet të dorëzohen deri në datën e 15 të muajit në vazhdim të fundit të muajve mars, qershor, shtator dhe dhjetor në formatin i cili është në pajtueshmëri me formatin kompatibil me standardet e përgjithëshme të pranuar të kontabilitetit dhe rregullat e kontabilitetit që janë në fuqi në Kosovë.
- 61.4 Raporti për çdo lloj ndryshimi në pronë dhe/ose në kontrollin e menaxhimit të Operatorit të Deponisë së Mbeturinave duhet të dorëzohet se paku një herë në vit jo më vonë se 15 janari i secilit vit kalendarik të dhënë dhe/ose brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga data ku cilido fakt relevant ka ndodhur që do të përcaktonte cilindo ndryshim në kontrollin e menaxhimit dhe/ose në pronësinë e Operatorit të Deponisë së Mbeturinave.
- 61.5 Jo më vonë se dhjetë (10) Ditë të Punës nga data kur ka ndodhë cilido ndryshim material në cilindo fakt ose informatë që përmban dokumenti i cili e ka shoqëruar Aplikacionin, Operatorët e Deponisë së Mbeturinave duhet të dërgojnë një verzion me të dhënat e fundit të atij dokumenti dhe/ose duhet të dërgojnë te Rregullatori të dhënat e fundit për informatën në format të cilin mund ta specifikojë Rregullatori kohë pas kohe ose me anë të komunikimit me shkrim.
- 61.6 Operatori i Deponisë së Mbeturinave duhet të njoftojë me shkrim Rregullatorin për cilatdo fakte ose situata të cilat kanë ngjarë dhe prodhuar rezultate që Operatori i Deponisë së Mbeturinave të mos jetë më në gjendje ti përmbush dhe/ose ka dështuar të përmbush kushtet dhe konditat të atyre lejeve zyrtare, autorizimeve ose pëlqimeve nga autoritetet tjera kompetente të konsideruara si esenciale për dhënien e Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave në pajtim me këtë Rregull.
- 61.7 Operatori i Deponisë së Mbeturinave është i obliguar të raportojë me shkrim te Rregullatori cilatdo fakte ose rrethana të cilat aktualisht dhe/ose potencialisht mund të ndikojn në pozitën e tyre ekonomike dhe financiare dhe/ose solvenitetin, kapacitetin e tyre Menagjues për të operuar dhe menaxhuar Deponinë e Mbeturinave dhe/ose disponueshmërinë e aktuale të ekspertizës teknike dhe resurseve të kërkuara për operim dhe menaxhim të duhur të Deponisë së Mbeturinave me standardet e përcaktuara nga Rregullatori, duke përfshirë pa kufizime kurdo qoftë:
- (a) cilido interes i sigurisë në asetet që janë të substanciale në ofrimin e Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave bëhet i detyrueshëm; dhe/ose
  - (b) cilido person merr posedimin mbi, apo cilido proces mbahet, imponohet apo ngrehet padija ndaj cilitdo asemi që është substancial për ofrimin e Shërbimeve për Deponimin e Mbeturinave nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave; dhe/ose
  - (c) cilido hap dhe/ose cilado mënyrë e veprimit ligjor ka filluar ose cilatdo hapa tjerë janë ndërmarrë për të bankrotuar ose likuiduar Operatorin e Deponisë së Mbeturinave ose për ta shpallur atë jo solvent.
- 61.8 Të gjitha shënimet duhet të mbahen në selinë e Operatorit të Deponisë së Mbeturinave dhe duhet të jenë në dispozicion gjatë orarit të rregullt të punës për tu kontrolluar nga Rregullatori.
- 61.9 Të gjitha shënimet dhe raportet e parapara në këtë Nen duhet të organizohen dhe të mbahen nga Operatori i Deponisë së Mbeturinave për r së paku 2 (dy) vite kalendarike

nga data ku ato janë pregatitur së pari ose u është caktuar afati, përveç nëse ndonjë ligj tjetër i aplikueshëm përcakton se ato duhet të mbahen për cilëndo periudhë më të gjatë kohore në të cilin rast periudha e fundit e mbajtjes duhet të aplikohet.

### **Kapitulli 3: Kundërvajtjet dhe Dënimet**

#### Neni 62: Kundërvajtjet dhe Dënimet

- 62.1 Dështimi për të përmbushur gjatë gjithë kohës cilatdo Kushte të Licencës së Shërbimit të përcaktuara nën këtë Rregull duhet të përbëjnë kundërvajtje dhe duhet të ndëshkojë Operatorin e Deponisë së Mbeturinave kundërvajtës me gjobë të vënë në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 e datës 26 Nëntor 2004, mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave.
- 62.2 Gjobat për shkelje të cilatdo prej Kushteve të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave gjithashtu do të caktohen në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë Rregull mbi vënien e gjobave dhe me cilatdo Rregulla tjera procedurale të përcaktuara nga Rregullatori kohë pas kohe.

### **Kapitulli 4: Ankesat**

#### Neni 63: Ankesat

- 63.1 Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ankohet te Komisioni i Shqyrtimeve i themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 e datës 26 Nëntor 2004, mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave ndaj cilatdo prej vendimeve konkrete të Rregullatorit të ndërmarra për çfarëdo çështje relevante, duke përfshirë pa kufizime, cilatdo:
- (a) Çështje, ndërrime, modifikime, ndryshime, plotësime, ripërtëritje, zgjerime dhe/ose modifikime në Licencën e Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave;
  - (b) Revokimi, deklarimi i ndërprerjes dhe/ose anulimi i Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave siç është e paraparë nga Rregullatori nën këtë Rregull;
  - (c) Vendosja dhe/ose zbatimi i cilatdo Kushteve të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave të paraparë nën këtë Rregull;
  - (d) Vënia e gjobave për cilëndo shkelje të Kushteve të Licencës së Shërbimit për Deponimin e Mbeturinave dhe/ose për shkeljen e cilësdo dispozitë të kësaj Rregulle;
- 63.2 Operatori i Deponisë së Mbeturinave gjithashtu mund të ankohet në gjyqet e Kosovës ndaj cilatdo vendimeve të Komisionit Shqyrtues të ndërmarra në cilatdo vendime konkrete për sa i përket zbatimit të kësaj Rregulle nga Rregullatori.
- 63.3 Me lëshimin e cilitdo vendim konkret për zbatimin e kësaj Rregulle, Rregullatori duhet të informojë Operatorin e Deponisë së Mbeturinave të cilit i drejtohet vendimi për të drejtën e tij për ankesë në pajtim me këtë Nen.

## PJESA 10: TË NDRYSHME

### Neni 64: Gjuhët


- 64.1 Ky Rregull lëshohet dhe publikohet në tri versione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë, respektivisht:
- (a) Anglisht
  - (b) Shqip
  - (c) Sërbisht
- 64.2 Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve në të cilat ky Rregull është lëshuar, versioni në gjuhën Angleze duhet të mirret si bazë.

### Neni 65: Hyrja në Fuqi

- 65.1 Ky Rregull do të hyjë në fuqi pas tridhjetë (30) ditëve prej datës së nënshkrimit
- 65.2 Operatorët e Deponisë së Mbeturinave të cilësdo Deponi të Mbeturinave ekzistuese dhe operative do të kenë tetë (8) muaj të bien në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulle të llogaritura nga data e hyrjes së saj në fuqi.



**Paulino Brillhante Santos**  
Drejtor



**Afrim Lajçi**  
Zëvendës Drejtor



**Ramiz Kokollari**

Udhëheqës i Seksionit të Financ. & Tarifave

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

**SHTOJCAT**



## SHTOJCA 1(a)

### FORMULARI I APLIKACIONIT PËR LICENCË TË SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE NË KOSOVË

NËPËRMJET TË KËTIJ FORMULARI PARASHTROHET APLIKACIONI TE ZYRJA E RREGULLATORIT PËR UJË DHE MBETURINA, PËR LICENCËN E SHËRBIMIT PËR DEPONIMIN E MBETURINAVE PËR TË OFRUAR SHËRBIME TË DEPONIMIT TË MBETURINAVE. NJOFTOJMË SE OFRIMI I INFORMATËS SË PASAKTË MUND PËRFUNDOJ NË REFUZIMIN E LICENCËS SË SHËRBIMIT			
KJO KËRKESË DUHET TË DËRGOHET TE:		VETËM PËR SHFRYTËZIM ZYRTAR	
<b>ZYRJA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA NDËRTESTA E BARDHË, Rruga BAJRAM KELMENDI PRISHTINË, KOSOVË</b>		<b>Data e Pranimit</b>	
		<b>Data e Marrjes</b>	
		<b>Data e Refuzimit</b>	
		<b>Taksa e paguar për Kërkesë</b>	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo
PJESA 1 – IDENTIFIKIMI I APLIKUESIT			
a) Emri i parashtruesit të Kërkesës:			
b) Adresa e biznesit			
c) Numri i telefonit		d) Numri i telefonit mobil	
e) Numri i faksit		f) Adresa elektronike (E-mail)	
g) Licenca e biznesit	Numri	Emri i entitetit lëshues	
PART 2 – INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM PËR PARASHTRUESIN E KËRESËS			
a) Lloji i parashtrimit të kërkesës <i>(Plotëso me “√” vetëm njëherë)</i>			
Parashtron Aplikacionin për të parën herë <input type="checkbox"/> Ripërtëritje <input type="checkbox"/> Ndryshim i pronësisë <input type="checkbox"/>			
b) Kategoria e parashtruesit të kërkesës <i>(Plotëso me “√”vetëm njëherë)</i>			
